

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ-Dega në Kaçanik, departamenti i përgjithshëm në përbërje të trupit gjykues Riza Livoreka kryetar i trupit gjykues, Kadri Rexha e Ibrahim Raka, anëtarë të trupit gjykues, me sekretarën juridike Azemine Berisha, duke vendosur në çështjen juridike të paditësit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], Komuna e [REDAKTUAR], të cilën me autorizim e përfaqëson [REDAKTUAR], avokate nga [REDAKTUAR], kundër të paditurës [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR] duke vendosur për çështjen kontestuese ndryshimi i aktgjykimit, në shqyrtimin gjyqësorë të mbajtur më dt.24.11.2017 morri dhe shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I. MIRATOHET, në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], Komuna e [REDAKTUAR] dhe NDRYSHOHET Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë C.nr.503/11, i dt. 01.11.2011 dhe tani e tutje fëmijët [REDAKTUAR] e lindur më dt. [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] i lindur më dt. [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], i lindur më dt. [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR] i BESOHEN në ruajtje dhe edukim babait të tyre – paditësit [REDAKTUAR] nga fshati [REDAKTUAR], Komuna e [REDAKTUAR]

II Detyrohet paditësi që ti paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 50.00 € ,e cila pages do të bëhet në afat prej 7 ditshë nga dita e pranimin të këtij aktgjykimi.

III. Ky Aktgjykim është i plotëfuqishëm që nga dt.24.11.2017, sepse palët ndërgjyqse kanë hjek dor nga e drejta e ankesës.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarës së sajë si në padi ashtu edhe në seancën e mbajtur gjyqësor, i ka propozuar gjykatës që kërkesë padinë e paditësit ta miratojë në tërësi si të bazuar dhe ka kërkuar që të ndryshohet aktgjykimi C.nr.503/11, i dt. 01.11.2011 sa i përket ruajtjes dhe edukimit të fëmijëve.

Me këtë padi ka kërkuar që fëmijët edhe atë [REDAKTUAR] e lindur më dt. [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] e lindur më dt. [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR], [REDAKTUAR] e lindur më dt. [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR], i lindur më dt. [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR], ti besohen në ruajtje dhe edukim babait të tyre për arsye se e paditura nuk ka mundësi që të kujdeset për këta

fëmij sepse të njejtit janë rritur ,dhe me rritjen e tyre janë shtuar edhe nevojat në të gjitha aspektet.

Po ashtu ka theksuar se e paditura nuk është duke e rrespektuar aktgjykimin C.nr 503/11 sa i përket besimit të fëmijeve sepse nuk është duke e rrespektuar kontaktin ashtu siq është shenuar në këtë aktgjykim, nga këto baza , i ka propozuar gjykatës që padia dhe kërkespadia të aprovohet si e bazuar.

Shpenzimet e procedures nuk i ka kërkuar.

E paditura në seancën gjyqësore ka deklaruar se mbetet në tërësi si në thënjet në përgjegjje në padi, duke i propozuar gjykatës që kërkesë padia e paditësit të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe të ndryshohet C.nr.503/11 i dt.01.11.2011 dhe të miturit ti besohen në ruajtje dhe edukim babait të tyre [REDACTED] për shkak se gjendja ekonomike ju ka vështërsuar.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Gjykata në seancën e dt. 24.11.2017, i ka dëgjuar edhe fëmijët [REDACTED], [REDACTED] dhe [REDACTED] dhe të njejtit kanë deklaruar se nuk e kontestojnë kërkesën e paditësit që të bëhet ndryshimi i aktgjykimit dhe të miturit ti besohen në ruajtje , edukim, dhe shkollim babait të tyre [REDACTED]

Gjykata një kopje të padisë me prova dhe aktvendimin për përgjigjje në padi i'a ka dorzuar të paditurës më dt.29.09.2017, e njejta pas pranimit të padisë me datën 30.10.2017, në gjykat ka paraqitur përgjigjje në padi me të cilen nuk e ka kontestuar kërkesëpadin e paditësit dhe i ka propozuar gjykatës që të ndryshohet aktgjykimi C.nr 503/11i datës 01.11.2011në paragrafin II dhe fëmijet ti besohen në ruajtje , edukim dhe shkollim paditësit respektivisht babait të tyre sepse të njejtit janë rrit dhe janë shtuar kërkesat e tyre për shkollim e të cilat kushte unë nuk mund tua plotësoj për shkak të gjendjes së vështir.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Për ta vërtetuar gjendjen e plotë faktike dhe gjykuar drejtë këtë qështje kontestimore juridiko-civile,gjykata me propozimin e palëve ndër gjyqje në procedurën e provave bëri administrimin e këtyre provave të shkruara:u lexua aktgjykimi C.nr503/11, çertifikatat e lindjes për femijet dhe pergjigjja në padi.

Pas vlerësimit me kujdes dhe me ndër gjegje të provave në tërësi dhe të secilës veq e veq e në pajtim me dispozitat e nen dhe 8 të LPK-së, si dhe bindjes së lirë të gjykatës, gjykata lidhur me këtë qështje kontestimore juridiko-civile vërtetoi këtë gjendje faktike:

Me aktgjykimin C.nr. 503/11 të dt.01.11.2011, është zgjidhur martesë në mes të paditësit dhe të paditurës, ndërsa fëmijet [redacted] e lindur më dt. [redacted] në [redacted], [redacted], e lindur më dt. [redacted] në [redacted], [redacted] e lindur më dt. [redacted] në [redacted] dhe [redacted], i lindur më dt. [redacted] në [redacted] i'a janë besuar në ruajtje edukim nënës së tyre [redacted]. Palët ndrygjgjëse kanë kërkuar që të ndryshohet aktgjykimi i lartshenuar dhe fëmijet ti besohen në ruajtje dhe edukim të më tutjeshëm babit të tyre [redacted] për arsye se e paditura tani i ka kushtet e vështira ekonomike dhe nuk mund të ja plotësoj kërkesat të tyre .

Gjykata e ndryshoi aktgjykimin C.nr.503/11 dhe vendosi që tani e tutje fëmijët ti besohen në ruajtje, edukimi paditësit [redacted] këtë e bëri duke u bazuar në deklaratat e palëve ndrygjgjëse e në veqanti në deklaratën e të paditurës të dhënë përmes përgjigjes në padi , dhe në séance gjyqësore e cila i ka propozuar gjykatës që kërkesë padinë ta miraton në tërsi si të bazuar.

Gjykata pas analizimit të provave e sidomos përgjegjës në padi ,deklaratës së të paditurës, deklaratës së fëmijëve të ciltë nuk e kanë kontestuar padinë e paditësit vendosi që ta miratoj kërkesë padinë dhe ta ndryshoj aktgjykimin e cituar më lartë dhe ruajtjen edukimin dhe shkollimin të i'a besoj paditësit konform nenit 143 dhe 144 të Ligjit për Familjen të Kosovës.

Gjykata i analizoj theksimet e paditësit të thëna në padi dhe këtyre theksimeve ua dha besimin dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi sepse e paditura nuk e ka kontestuar kërkesën për ndryshimin e aktgjykimit andaj vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

Gjykata i analizoi edhe theksimet e palës së paditur e cila i propozoj gjykatës që kërkesë padinë e paditësit ta miratoj në tërsi si të bazuar, këtyre theksimeve ua dha besimin dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.



Ky aktgjykim është i plotfuqishëm që nga dt.24.11.2017, sepse palët ndrygjgjëse kanë hjek dor nga e drejta e ankesës.

Gjykata e detyroi paditësin që ti paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shum prej 50 €, sepse pala paditëse këtë shumë nuk e ka paguar me rastin e dorzimit të padisë në gjykatë ashtu siq është pararë në dispozitivin e nenit 253 par.5 si dhe conform nenit 452 të LPK-së dhe Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore 01/2017.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

C.nr.186/2017 prej 24.11.2011.



Gjyqtari,
Riza Livoreka

3

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
DITI UKA JE PRAVNOSNAZNA
GJYKATA THEMELORE FERIZAJ DEGA NË KAÇANIK
OSNOVNI SUD FERIZAJ DEGA NË KAÇANIK
Me 24 11. 20 17
Dana